

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	01.01.2021	Kërkesë për bonus bebi	05.01.2021	<p>Përshëndetje i nderuar,</p> <p>Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se fëmija duhet të regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile brenda 90 ditëve nga momenti i lindjes.</p> <p>Masa e shpërblimit për lindjen e fëmijës janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 40 000 (dyzet mijë) lekë për lindjen e fëmijës së parë; • 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për lindjen e fëmijës së dytë; • 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për lindjen e fëmijës së tretë dhe fëmijëve të tjerë në vijim; <p>Sa më sipër, ju njoftojmë se motra juaj do të përfitoj 120 000 lekë për fëmijën e saj të katërt.</p> <p>Sa i përket procedurës së tërheqjes së çekut (bonusi), ajo bëhet personalisht nga prindi/prindërit dhe afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës.</p>	E plotë	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

				<p>Për çdo pyetje ose paqartësi, ju udhëzojmë të ndiqni faqen zyrtare të ADISA, në linkun në vijim http://www.adisa.gov.al/lindja/, ku jepet një informacion i detajuar mbi bonusin e bebes.</p> <p>Gjithashtu, mund të kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p> <p>Gjithë të mirat!</p>		
2	02.01.2021	Kërkesë për tërheqjen e çekut të bebes	05.01.2021	<p>Përshëndetje e nderuar,</p> <p>Në vijim të pyetjes, Ju informojmë se me Prokurë të Posaçme mund të autorizoni një të afërm të kryejë tërheqjen e çekut të bebes dhe afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës. Personi i autorizuar duhet të paraqitet pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetësor, në Sektorin e financës, me qëllim dorëzimin e dy certifikatave (familjare dhe lindje e fëmijës) dhe përfitim të çekut të bonusit të lindjes, sipas masës së përcaktuar.</p> <p>Për çdo pyetje ose paqartësi, ju udhëzojmë të ndiqni faqen zyrtare të ADISA, në linkun në vijim http://www.adisa.gov.al/lindja/, ku jepet një informacion i detajuar mbi të gjitha hapat që duhet të ndiqen dhe shpërblimet që përfitohen.</p> <p>Gjithashtu, mund të kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e hëna në të premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p> <p>Gjithë të mirat!</p>	E plotë	Nuk ka
3	04.01.2021	Informacion rreth hapjes së qendrës ADISA Shkodër	05.01.2021	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në vijim të kërkesës Suaj për informacion, Ju bëjmë me dije se qendrat ADISA janë të hapura nga dita e sotme , nga ora 08:00 deri në 15:00 .</p> <p>Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p> <p>Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka
4	04.01.2021	Informacion rreth hapjes së	05.01.2021	<p>Përshëndetje,</p>	E plotë	Nuk ka

		qendrës ADISA Kavajë		Në vijim të kërkesës Suaj për informacion, Ju bëjmë me dije se qendrat ADISA janë të hapura nga dita e sotme , nga ora 08:00 deri në 15:00 . Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
5	05.01.2021	Info ne lidhje me aplikimin e rivlerësimit të pasurisë	05.01.2021	Pershendetje, me afat ligjor i referohemi afateve te vendosura nga ASHK per levrimin e nje sherbimi te caktuar dhe jo afateve te ADISA. Ju lutemi lexoni me kujdes e - malin e derguar nga ADISA, pasi Ju kemi cituar se aplikimi juaj nuk eshte punuar dhe jo nuk eshte pranuar. E thene ndryshe ASHK duhet te ishte pergjigjur apo te kishte ofruar sherbimin e saj brenda afatit te percaktuar ne kopjen e kerkeses Tuaj. Per kete arsye Ju sugjeruam te dergoni ankese ne portalin Shqiperai qe Duam. Duke Ju falenderuar,	E plotë	Nuk ka
6	05.01.2021	Info rreth hapjes së qendrave ADISA	05.01.2021	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se qendrat ADISA janë të hapura nga dita e sotme , nga ora 08:00 deri në 15:00 . Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
7	05.01.2021	Kërkesë për info mbi shpalljen e	05.01.2021	Përshëndetje,	E plotë	Nuk ka

		<p>martesës me shtetas të huaj</p>		<p>Në vijim të kërkesës Suaj për informacion, Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të kryeni shpalljen e martesës , procedura për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar në Republikën e Shqipërisë është si mëposhtë vijon: Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesë. Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; • certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martesë”; • fotokopje e dokumentit të identifikimit; <p>Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martesë. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë.</p> <p>Në rast se "Lidhja e martesës do të kryhet ndërmjet një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj" procedura për të bërë shpalljen është si mëposhtë vijon :</p>		
--	--	------------------------------------	--	--	--	--

			<p>Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> · certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; · dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); · dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; · fotokopje e dokumentit të identifikimit; <p>Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar.</p> <p>Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> · certifikatë lindje; · certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”; <p>Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.</p> <p>Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin.</p> <p>Lidhur me pyetjen tuaj , ju informojmë se shpallja e martesës në Shqipëri duhet të kryhet me dokumentat shqiptare, për më shumë informacion mund të pyesni edhe pranë gjendjes tuaj civile.</p> <p>Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p> <p>Faleminderit!</p>		
8	05.01.2021	Info rreth ndërrimit të emrit në lejen e qarkullimit të mjetit	05.01.2021	<p>Pershendetje,</p> <p>Ne vijim te kerkeses Suaj per informacion, ju bejme me dije se nderrimi i emrit ne lejen e qarkullimit te mjetit, nuk ofrohet ne Adisa Kruje, por ne Drejtorine Rajonale te Sherbimeve te Transportit Rrugor Durres.</p> <p>Per cdo pyetje apo paqartesi na kontaktoni ne kanal in informativ pa pagese 0800 0118 nga e hena ne te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00 ose online chat, nga e hena ne te premte ne fashen orare 08.00 – 16.00</p> <p>Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka
9	05.01.2021	Info rreth efekteve fiskale të biznesit	08.01.2021	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në vijim të pyetjeve tuaja, ju bëjmë me dije si më poshtë:</p> <p>Në momentin e regjistrimit të biznesit tuaj në regjistrin tregtar, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) njofton në mënyrë elektronike organet tatimore (qëndrore dhe vendore) për regjistrimin e një subjekti të ri për efekte fiskale si dhe përcjell elektronikisht të dhënat e subjektit (NUIS/NIPT etj.) . Për këtë qëllim, duhet të ndiqni të gjitha hapat, deklaratimet dhe pagesat që duhet të kryeni sipas kalendarit të deklaratimeve të publikuar në linkun në vijim: https://www.tatime.gov.al/c/4/128/kalendari-</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>tatimor. Për informacion më të zgjeruar, Ju udhëzojmë t'i drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për të marrë informacionin e kërkuar, sipas kontakteve të mëposhtme: Telefon: 04 22 76 840 Postat elektronike: e-tatime@tatime.gov.al dhe hermelinda.hysenaj@tatime.gov.al Gjithë të mirat!</p>		
10	05.01.2021	Info rreth nr personal të shtetasve të huaj, qëllim shpalljen e martesës	06.01.2021	<p>Përshëndetje e nderuar, Ne vijim të pyetjes tuaj, Ju udhëzojmë të kontaktoni me koordinatorin për të drejtën e informimit në Ministrinë e Brendshme, institucion i cili ka në varësi Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në mënyrë që të informoheni mbi pyetjen tuaj. Të dhënat e kontaktit për Ministrinë e Brendshme janë si më poshtë: Koordinatori për të drejtën e informimit: z. Ardian Bita - ardian.bita@mb.gov.al Gjithë të mirat!</p>	E plotë E deleguar	Nuk ka
11	06.01.2021	Info rreth ndryshimit të mbiemrit	08.01.2021	<p>Përshëndetje i nderuar, Ne vijim të pyetjes tuaj, Ju udhëzojmë të kontaktoni me koordinatorin për të drejtën e informimit në Ministrinë e Brendshme, institucion i cili ka në varësi Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), në mënyrë që të informoheni mbi pyetjen tuaj. Të dhënat e kontaktit për Ministrinë e Brendshme janë si më poshtë: Koordinatori për të drejtën e informimit: z. Ardian Bita - ardian.bita@mb.gov.al</p>	E plotë E deleguar	Nuk ka

				Gjithë të mirat!		
12	06.01.2021	Info rreth efekteve fiskale të biznesit	08.01.2021	<p>Përshëndetje i nderuar,</p> <p>Në vijim të email-it tuaj, Ju bëjmë me dije si më poshtë:</p> <p>Në momentin e regjistrimit të aktivitetit tuaj në regjistrin tregtar, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) njofton në mënyrë elektronike organet tatimore (qëndrore dhe vendore) për regjistrimin e një subjekti të ri për efekte fiskale si dhe përcjell elektronikisht të dhënat e subjektit (NUIS/NIPT etj.). Për këtë qëllim, duhet të komunikoni me QKB, për të marrë një informacion mbi procedurën që duhet të ndiqni dhe ta kaloni aktivitetin tuaj në status pasiv. Kontaktet janë si më poshtë:</p> <p>Telefon: +355 4 2250066</p> <p>Adresa elektronike: info.qkb@qkb.gov.al</p> <p>Faleminderit!</p>	E plotë E deleguar	Nuk ka
13	06.01.2021	Info rreth shërbimit "Aplikim për regjistrim fillëstar të personit fizik"	08.01.2021	<p>Përshëndetje e nderuar,</p> <p>Në vijim të kërkesës suaj, Ju bëjmë me dije si më poshtë:</p> <p>Portali e-Albania Ju mundëson që shërbimin për regjistrim fillestar të një sipërmarrjeje ta bëni përmes internetit, duke zgjedhur këtë lidhje elektronike:</p> <p>https://ealbania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=48&institution_name=Qendra%20Komb%20e%20Biznesit%20(QKB)&service_type=Y.</p> <p>Më pas mund të përzgjidhni shërbimin me emërtimin: "Aplikim për regjistrim fillestar të personit fizik".</p> <p>Gjithashtu, Ju njoftojmë se portali përdoret pasi të keni hapur një llogari në të. Nëse nuk e keni një të tillë, mund ta bëni duke zgjedhur këtë lidhje:</p> <p>https://e-albania.al/Pages/HelpRegister.aspx.</p> <p>Në vijim, për çdo paqartësi apo problem të hasur në përdorimin e portalit e-Albania, mund t'i drejtoheni postës</p>	E plotë	Nuk ka

				elektronike – helpdesk@e-albania.al – kanal i posaçëm për përdorimin e portalit. Gjithë të mirat!		
14	06.01.2021	Info rreth tokave që jep shteti me qira	07.01.2021	Pershendetje, Ju duhet te interesoheni prane Njesise Administrative perkatese. Duke Ju falenderuar,	E plotë	Nuk ka
15	06.01.2021	Kërkesë për info mbi shpalljen e martesës me shtetas të huaj	11.01.2021	Përsëhendetje, Në vijim të pyetjeve tuaja, ju bëjmë me dije si më poshtë: Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku ju keni vendbanimin. Nëse jeni ende e regjistruar në Dropull, duhet të dërgoni letrat në zyrën e gjendjes civile të Dropullit. Për çdo pyetje ose paqartësi, ju udhëzojmë të ndiqni faqen zyrtare të ADISA, në linkun në vijim http://www.adisa.gov.al/martesa/ ku jepet një informacion i detajuar mbi lidhjen e martesës. Gjithashtu, mund të kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118 , nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Gjithë të mirat!	E plotë	Nuk ka
16	06.01.2021	Info rreth tokave që jep shteti me qira	06.01.2021	Pershendetje, Ne vijim te kerkeses Suaj per informacion, ju bejme me dije, kerkesa Juaj eshte jashte fokusit te institucionit tone. Informacion per percaktimin e kriterëve, procedurës, dhe menyres se dhenies me qera te pasurise shteterore e gjeni ne linkun e meposhtem: https://infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Nr.54_date_05.02.2014.pdf Per cdo pyetje apo paqartesi na kontaktoni ne kanalim informativ pa pagese 0800 0118 nga e hena ne te premte ne fashen orare	E plotë E deleguar	Nuk ka

				08.00 – 19.00 ose online chat, nga e hena ne te premte ne fashen orare 08.00 – 16.00 Faleminderit		
17	06.01.2021	Kërkesë për bonus bebi	06.01.2021	Pershendetje, Ne vijim te kerkeses Suaj per informacion, ju bejme me dije se ju perfitoni 80. 000 leke te reja si bonus per lindjen e dyte. Per cdo pyetje apo paqartesi na kontaktoni ne kanal in informativ pa pagese 0800 0118 nga e hena ne te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00 ose online chat, nga e hena ne te premte ne fashen orare 08.00 – 16.00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
18	07.01.2021	Kërkesë për shërbimin akt verifikimi	08.01.2021	Pershendetje, ne vijim do te gjeni hapat e nevojshme qe duhen ndjekur per te marre sherbimin e kerkuar: 1. ne seksionin "kerko sherbimin", Ju duhet te kerkoni te njejtin sherbim te aplikuar per te cilin Ju ka ardhur ky akt verifikim; 2. Pasi te klikoni opsionin "Perdor" , Ju duhet te shkoni ne fund te faqes se shfaqur dhe te plotesoni fushat perkatese (bashkelidhur ne foto seksioni qe duhet plotesuar). Nese keni veshtiresi te aplikoni nepermjet portalit, Ju mund ti drejtoheni sporteleve fizike te ADISA. Sportelet i gjeni: - ADISA, Njesia Administrative numer 6, Kombinat. - ADISA, Rruga "Panorama", (ish - hipoteka e Tiranes) Ne te njejtin kohe Ju mund te na kontaktoni nepermjet sherbimit Call Center ne numrin pa pagese 0800 - 0118. Duke Ju falenderuar	E plotë	Nuk ka
19	07.01.2021	Asistencë për rikuperimin ellogarise ne eAlbania.	08.01.2021	Përshëndetje e nderuar, Në vijim të pyetjes Tuaj, ju bëjmë me dije se për çdo problem me përdorimin e portalit e-Albania, të përdorni këtë lidhje elektronike – https://e-albania.al/Pages/Contact.aspx . Plotësoni rubrikat me të dhënat tuaja dhe, në zërin “Përmbajtja”, përshkruani problemin tuaj. Gjithashtu mund t'i drejtoheni edhe postës elektronike – helpdesk@e-albania.al – kanal i posaçëm për përdorimin e portalit e-Albania. Gjithë të mirat!	E plotë	Nuk ka

20	07.01.2021	Asistenë rreth aplikimit në e-filing	11.01.2021	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në vijim të kërkesës suaj, gjeni bashkëlidhur linkun: https://www.tatime.gov.al/c/7/200/udhezues-perdorimi i cili ju shërben për t'ju orientuar mbi procedurat e aplikimit në e-filing dhe zgjidhjet e mundshme për problematika të ndryshme gjatë procesit të ngarkimit të dokumenteve.</p> <p>Gjithashtu, për më tepër informacion, ju lutemi të kontaktoni me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve në adresat e mëposhtme: Adresa elektronike: dsht.Tirana@tatime.gov.al Telefon: +355 42425903</p>	E plotë E deleguar	Nuk ka
21	07.01.2021	Info mbi bonusin e bebit	11.01.2021	<p>Përshëndetje i nderuar,</p> <p>Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se tërheqja e çekut (bonusi), bëhet personalisht nga prindi/prindërit dhe afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës.</p> <p>Për çdo pyetje ose paqartësi, ju udhëzojmë të ndiqni faqen zyrtare të ADISA, në linkun në vijim http://www.adisa.gov.al/lindja/, ku jepet një informacion i detajuar mbi bonusin e bebes.</p> <p>Gjithashtu, mund të kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Gjithë të mirat!</p>	E plotë	Nuk ka
22	07.01.2021	Info rreth lejes së punës	11.01.2021	<p>Dear sir,</p> <p>Following your request, we would like to inform that you can find this information in the following link https://punetejashtme.gov.al/en/aplikim-per-vize/. Based on your request, for you is more convenient the Visa Type "D".</p> <p>You can also send a request for information to the email address: liridona.boci@mfa.gov.al.</p> <p>Best regards,</p>	E plotë E deleguar	Nuk ka
23	08.01.2021	Info rreth ndryshimit të adresës së biznesit	11.01.2021	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në vijim të pyetjes Tuaj, Ju lutemi të kontaktoni në adresat e mëposhtme të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për të marrë një informacion mbi procedurën që duhet të ndiqni: Telefon: +355 4 2250066 Adresa elektronike: info.qkb@qkb.gov.al</p>	E deleguar	Nuk ka

24	08.01.2021	Info rreth pensionit të pleqërisë	08.01.2021	<p>Pershendetje, Ne vijim te kerkeses Suaj per informacion, Ju bejme me dije se, ne rastet kur qytetari e ka te demtuar apo i mungon libreza e punës, qoftë për faj të ish-ndërmarrjeve, apo të vetë qytetarit, me aplikimin për pension apo për përfitime të tjera, qytetari plotëson një formular ku përfshihen rubrikat; periudha e punuar fillim – mbarim, (ditë, muaj, vit) subjektet ku qytetari ka punuar, sektori brenda subjektit.</p> <p>Në rast se qytetari nuk është i sigurt për datën e fillimit e deklaron atë me afërsi. Zakonisht kjo kërkesë bëhet në kërkesën paraprake për pension, 1 vit para plotësimit të moshës, për t’i paraprirë caktimit në kohë të pensionit.</p> <p>Duke pasur këtë kërkesë dhe gjeneralitet e kërkuesit, si emër, atësi, mbiemër, vendi dhe data e lindjes, vendbanimi, punonjësit e sigurimeve shoqërore i referohen regjistrin themeltar të subjektit të fundit ku ka punuar qytetari. Në rast se në këtë subjekt janë të mbartura të gjitha periudhat sipas kërkesës, problemi konsiderohet i zgjidhur dhe plotësohet vërtetimi i vjetërsisë në punë sipas rubrikave të rezultuara në regjistër.</p> <p>Ne rast se te dhenat e mesiperme nuk gjenden ne regjistrat e dorezuar ne ISSH nga subjektet e deklaruar nga qytetari ne aplikimin "Kerkese paraprake per pension pleqerie", e vetmja zgjidhje mbetet vertetimi ne gjykate.</p> <p>Per cdo pyetje apo paqartesi na kontaktoni ne kanal in formativ pa pagese 0800 0118 nga e hena ne te premt e fashen orare 08.00 – 19.00 ose online chat, nga e hena ne te premt e fashen orare 08.00 – 16.00</p>	E plotë	Nuk ka
25	08.01.2021	Info për certifikatën e martesës	11.01.2021	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës suaj, Ju bëjmë me dije si më poshtë: Aplikimin për certifikatë martesë mund ta bëni online vetëm nëse jeni rezident në shtetin e Italisë pasi këto certifikata lëshohen vetëm në Përfaqësitë Diplomatike dhe Konsullore të Shqipërisë të akredituara në Itali.</p> <p>Ky shërbim u jep mundësinë qytetarëve shqiptarë rezidentë në Itali, të aplikojnë online për të marrë më pas, nëpërmjet shërbimit postar, certifikatën e martesës. Pas verifikimeve të nevojshme të</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>kryera nga përfaqësues të Ambasadës/Konsullatës, pranohet aplikimi dhe aplikanti ftohet më pas të ndjekë procedurat për të kryer pagesën dhe për të dërguar mandatin origjinal (<i>jo fotokopje</i>) me postë.</p> <p>Kthimi i përgjigjes kryhet me e-mail tek ju dhe më pas njoftoheni për dërgimin e certifikatës së martesës me postë në adresën e qytetarit.</p> <p>Sa më sipër, në rast se jeni rezident në Itali, aplikimi kryhet në nëpërmjet platformës e-Albania më link-un në vijim: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9486.</p> <p>Në rast se jeni rezident në një shtet tjetër dhe/ose Ju nevojitet informacion shtesë, Ju lutemi të kontaktoni në adresat si më poshtë:</p> <p>Adresa elektronike: info@mfa.gov.al</p> <p>Telefon: +355 42340358</p> <p>Gjithë të mirat!</p>		
26	08.01.2021	Info rreth pagesës për pajisjen me licencë individuale	11.01.2021	<p>Përshëndetje I nderuar,</p> <p>Në vijim të kërkesës suaj, Ju bëjmë me dije se në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në link-un në vijim https://www.infrastruktura.gov.al/regjistri-i-licencave/, do të gjeni të publikuar faturën për arkëtim, e cila është e nevojshme për ta paraqitur pranë cdo banke të nivelit të dytë, për të kryer pagesën e aplikimi për shërbimin që ju kërkoni.</p> <p>Për një informacion më të zgjeruar, Ju udhëzojmë të kontaktoni me drejtorinë përkatëse të licencave, për t'ju informuar mbi gjithë procedurën që duhet të ndiqni https://www.infrastruktura.gov.al/kontakto-me-drejtorene-perkatese/</p> <p>Duke Ju falënderuar!</p>	E plotë E deleguar	Nuk ka
27	08.01.2021	Info rreth aplikimit për pasaportë	11.01.2021	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në vijim të email-it tuaj, Ju bëjmë me dije si më poshtë:</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>Aplikim për pasaportë, është një shërbim elektronik, i cili u mundëson qytetarëve shqiptarë rezidentë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, të aplikojnë online për t'u pajisur me pasaportë dhe kartë identiteti. Pas verifikimeve të nevojshme të kryera nga përfaqësues të Ambasadës/Konsullatës, pranohet aplikimi dhe aplikanti ftohet të ndjekë procedurat për të kryer pagesën dhe për të dërguar mandatin origjinal (<i>jo fotokopje</i>) me postë. Qytetari është i detyruar të paraqitet më pas në përfaqësi për të lënë shenjat e gishtërinjve.</p> <p>Aplikimin, mund ta kryeni në link-un në vijim: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9765</p> <p>Gjithashtu, Ju njoftojmë se portali përdoret pasi të keni hapur një llogari në të. Nëse nuk e keni një të tillë, mund ta bëni duke zgjedhur këtë lidhje: https://e-albania.al/Pages/HelpRegister.aspx.</p> <p>Në vijim, për çdo paqartësi apo problem të hasur në përdorimin e portalit e-Albania, mund t'i drejtoheni postës elektronike – helpdesk@e-albania.al – kanal i posaçëm për përdorimin e portalit.</p> <p>Gjithë të mirat!</p>		
28	09.01.2021	Info mbi vjetërsinë e punës	15.01.2021	<p>Përrshëndetje e nderuar,</p> <p>Në vijim të kërkesës suaj, Ju bëjmë me dije si më poshtë: Portali e-Albania ju mundëson që shërbimin për vjetërsi pune ta bëni përmes internetit, duke zgjedhur shërbimin sipas kontributeve që keni derdhur në lidhjet elektronike të mëposhtme: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13908 https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=5035</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13888</p> <p>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13886</p> <p>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13885</p> <p>Më pas mund të përzgjidhni shërbimin e volitshëm për ju sipas sigurimeve shoqërore të derdhura me emërtimin: “Vërtetim për periudha pune...” etj.).</p> <p>Gjithashtu, Ju njoftojmë se portali përdoret pasi të keni hapur një llogari në të. Nëse nuk e keni një të tillë, mund ta bëni duke zgjedhur këtë lidhje: https://e-albania.al/Pages/HelpRegister.aspx.</p> <p>Në vijim, për çdo paqartësi apo problem të hasur në përdorimin e portalit e-Albania, mund t’i drejtoheni postës elektronike – helpdesk@e-albania.al – kanal i posaçëm për përdorimin e portalit.</p> <p>Gjithë të mirat!</p>		
29	09.01.2021	Info rreth raporteve të lindjes	15.01.2021	<p>Përshëndetje e nderuar,</p> <p>Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se nëse fëmija juaj lind në Shqipëri ju do të pajiseni me raport lindje prej 63 ditësh në materniteti. Më pas ky raport dorëzohet në institucionin ku gruaja juaj punon.</p> <p>Nëse fëmija juaj lind në Itali, ju duhet të paraqisni dokumentacionin që do ju vënë në dispozicion në Itali pranë Qendrës së Konsultores ku është e regjistruar gruaja juaj.</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>Për çdo pyetje ose paqartësi mund të kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p> <p>Gjithë të mirat!</p>		
30	10.01.2021	Info rreth rinovimit të lejes drejtimit	15.01.2021	<p>Përshëndetje e nderuar,</p> <p>Në vijim të kërkesës tuaj, Ju informojmë se ju mund të aplikoni pranë sportleve të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë me vendndodhje Kashar.</p> <p>Mund të rezervoni takim nëpërmjet faqes zyrtare dpshttr.gov.al ose mund të paraqiteni direkt në sportel. Ju informoj që sportelet ditën e mërkurë janë të hapura deri në orën 19.00.</p> <p>Patenten e re mund ta tërhiqni 30 minuta pas kryerjes së aplikimit në sportelet e DPSHTRR tek Nsheraku</p> <p>Për çdo pyetje apo paqartësi, mund të kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p> <p>Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka
31	10.01.2021	Info rreth tërheqjes së lekëve të raportit lindjes	15.01.2021	<p>Përshëndetje I nderuar,</p> <p>Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije se kërkesën tuaj e kemi përcjellë tek koordinatori për të drejtën e informimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, autoriteti përgjegjës për shërbimin e kërkuar nga ju.</p> <p>Të dhënat e kontaktit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore: Koordinatori për të drejtën e informimit pranë ISSH-së: znj. Xhoana Koxhaj.</p> <p>Nr. tel: +355 682059077; +355 692075088</p> <p>Posta elektronike: iss@iss.gov.al</p>	E deleguar	Nuk ka

32	10.01.2021	Info rreth kalimit të truallit buqësor, truall ndërtim nga në për	11.01.2021	Pershendetje, Ju duhet te paraqiteni prane Njesie Administrative ku ndodhet pasuria. Duke Ju falenderuar,	E plotë	Nuk ka
33	11.01.2021	Kërkesë për aktivizim biznesi	11.01.2021	Përsëndetje I nderuar, Në vijim të kërkesës suaj, Ju bëjmë me dije si më poshtë: Portali e-Albania ju mundëson që shërbimin për të cilin interesoheni mund ta gjeni me emrin Kërkesë për aktivizim biznesi . Si fillim identifikohuni në portal me nr NIPT. Më pas mund të përzgjidhni shërbimin, konkretisht me emërtimin: “Kërkesë për aktivizim biznesi” (person fizik, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionare, etj.) Në vijim, për çdo paqartësi apo problem të hasur në përdorimin e portalit e-Albania, mund t’i drejtoheni postës elektronike – helpdesk@e-albania.al – kanal i posaçëm për përdorimin e portalit. Gjithë të mirat!	E plotë	Nuk ka
34	11.01.2021	Info rreth kryerjes së pagesë nga portali	12.01.2021	Pershendetje, I vetmi opsion per te kryer pagesen nga portali eshte nepermjet nje llogarie bankare apo karte debiti te bankse CREDINS. Nese llogaria Juaj i perket nje tjetere banke, atehere pagesa duhet kryer ne njerin prej degeve. Duke Ju falenderuar,	E plotë	Nuk ka
35	11.01.2021	Info rreth regjistrimit të fëmijës	11.01.2021	Përsëndetje e nderuar, Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se është detyrim ligjor regjistrimi i fëmijës Tuaj edhe pranë Zyrës së Gjendjes Civile ku jeni regjistruar. Ky regjistrim nuk mund të bëhet nëpërmjet portalit e-albania por mund ta kryhet nga një i	E plotë	Nuk ka

			<p>afërmi juaj pranë Zyrave të Gjendjes Civile. Pë kryerjen e këtij veprimi keni kohë 30 ditë nga dita e lindjes së bebit. Për të kryer regjistrimin e fëmijës në regjistrin kombëtar të popullsisë në Shqipëri, duhet të dërgoni pranë familjarëve tuaj këto dokumenta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prokurë e Posaçme për personin që do të kryejë regjistrimin dhe kopje të letërnjoftimeve elektronike të dy prindërve; • Aktin e lindjes të mbajtur jashtë shtetit, i cili duhet të jetë legalizuar me vulë Apostile dhe i përkthyer në gjuhë n shqipe dhe i noterizuar. <p>Në përfundim të regjistrimit të të porsalindurit, me qëllim përftimin e bonusit, nëpunësi i gjendjes civile ju pajis me 2 (dy) certifikata, përkatësisht: Certifikatë familjare dhe Certifikatë lindje e të porsalindurit, më shënimin “Për bonusin e lindjes”.</p> <p>Në vijim, prindi pajiset me Regjistrimin e aktit të lindjes, Certifikatën e aktit të lindjes, Certifikatën familjare dhe Certifikatën personale të të porsalindurit. Tërheqja e çekut (bonusi) bëhet personalisht nga prindi/prindërit dhe afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës. Në rast se ju nuk mund të jeni të pranishëm, me një Prokurë të Posaçme mund të autorizoni një të afërm të bëjë regjistrimin e fëmijës, si edhe të kryejë edhe tërheqjen e çekut të bebes.</p> <p>Personi i autorizuar (<i>i pajisur me prokurë të posaçme</i>) duhet të paraqitet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në Sektorin e financës, me qëllim dorëzimin e dy</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>certifikatave (familjare dhe lindje e fëmijës) dhe përfitim e çekut të bonusit të lindjes, sipas masës së përcaktuar.</p> <p>Për çdo pyetje ose paqartësi mund të kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p> <p>Gjithë të mirat!</p>		
36	11.01.2021	Info mbi kryerjen e aplikimit për licencë	11.01.2021	<p>Përsëndetje I nderuar,</p> <p>Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se për t'u informuar mbi procedurën dhe dokumentacionin e nevojshëm për të kryer aplikimin për licencë, duhet të kontaktoni me Sektorin e Licencave ne Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nga e hëna në të enjte, ora 08:00 - 16:30 dhe të premten 08:00-14:00.</p> <p>Për më tepër informacion, Ju lutem kontaktoni në adresën në vijim, http://infrastruktura.gov.al/kontakto-me-drejtorine-perkatese/ duke plotësuar të gjitha fushat e kërkuara dhe më pas butonin dërgo.</p> <p>Duke Ju falënderuar!</p>	E plotë E deleguar	Nuk ka
37	11.01.2021	Formularë për regjistrim (DPSHTRR)	11.01.2021	<p>Përsëndetje ,</p> <p>Në vijim të komunikimit në kanalin informativ online chat, bashkëlidhur emailit gjeni formularin sipas kërkesës suaj.</p> <p>Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p> <p>Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka
38	11.01.2021	Info rreth statusit të naftëtarit	11.01.2021	<p>Pershendetje,</p> <p>Ne vijim te kerkeses Suaj per informacion, ju bejme me dije se statusin e naftetarit e perfitojne:</p> <p>Meshkujt qe kane punuar ne sektoret e naftes ne moshen 60 vjec, dhe femrat ne moshen 55 vjec</p> <p>Vitet qe duhet te kene punuar ne kete sektor 25 vite.</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>Per t'u informuar nese ju me 9 vite pune perfitoni apo jo nga statusi i naftetarit duhet te drejtoheni per informacion ne Agjencine Rajonale te Sigurimeve Shoqerore Vlore.</p> <p>Nese jeni perfituese e pensionit te pleqerise, aplikoni ne e-albania sherbimin:</p> <p>Aplikim për pension pleqërie, suplementar pilot, suplementar lundrues i nëndetëseve apo suplementar për akademik https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6156</p> <p>Per cdo pyetje apo paqartesi na kontaktoni ne kanal in informativ pa pagese 0800 0118 nga e hena ne te premt e fashen orare 08.00 – 19.00 ose online chat, nga e hena ne te premt e fashen orare 08.00 – 16.00</p>		
39	11.01.2021	Info mbi përfitimin e ndihmës ekonomike	11.01.2021	<p>Pershendetje,</p> <p>Ne vijim te kerkeses Suaj per informacion, ju bejme me dije se per perfitimin e ndihmes ekonomike, apo pagesen e papunesise, duhet te regjistrohemi me pare si Punekerkuet i Papune.</p> <p>Sherbimi aplikohet ne e-albania ne linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12550</p> <p>Nese nuk arrini te aplikoni, paraqituni ne sportelet Adisa qe T Ju asistojne specialistet.</p> <p>Per cdo pyetje apo paqartesi na kontaktoni ne kanal in informativ pa pagese 0800 0118 nga e hena ne te premt e fashen orare 08.00 – 19.00 ose online chat, nga e hena ne te premt e fashen orare 08.00 – 16.00</p>	E plotë	Nuk ka
40	11.01.2021	Kërkesë për info mbi bonusin e bebit	12.01.2021	<p>Përshëndetje e nderuar,</p> <p>Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se tërheqja e çekut (bonusi) bëhet personalisht nga prindi/prindërit dhe</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës. Në rast se ju nuk mund të jeni të pranishëm, me një Prokurë të Posaçme mund të autorizoni një të afërm të bëjë regjistrimin e fëmijës, si edhe të kryejë edhe tërheqjen e çekut të bebes.</p> <p>Për të kryer regjistrimin e fëmijës në regjistrin kombëtar të popullsisë në Shqipëri, duhet të dërgoni pranë familjarëve tuaj këto dokumenta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prokurë e Posaçme për personin që do të kryejë regjistrimin dhe kopje të letërnjoftimeve elektronike të dy prindërve; • Aktin e lindjes të mbajtur jashtë shtetit, i cili duhet të jetë legalizuar me vulë Apostile dhe i përkthyer në gjuhë n shqipe dhe i noterizuar. <p>Personi i autorizuar (<i>i pajisur me prokurë të posaçme ose prindi</i>) duhet të paraqitet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në Sektorin e financës, me qëllim dorëzimin e dy certifikatave (familjare dhe lindje e fëmijës) dhe përfundimin e çekut të bonusit të lindjes, sipas masës së përcaktuar.</p> <p>Për çdo pyetje ose paqartësi mund të kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p> <p>Gjithë të mirat!</p>		
41	11.01.2021	Info mbi shërbimin “Lëshim vërtetimi për objektet Pasuri Kulturore të	12.01.2021	<p>Përshëndetje I nderuar,</p> <p>Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë: Për të marrë shërbimin e kërkuar mund të aplikoni në portalin e-Albania.</p>	E plotë	Nuk ka

		<i>regjistruara në Bazën e të Dhënave Shtetërore</i>		<p>Hyni në portal dhe identifikohuni, më tej me search kërkoni shërbimin Lëshim vërtetimi për objektet Pasuri Kulturore të regjistruara në Bazën e të Dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore dhe përzgjidhni rubrikën "Përdor".</p> <p>Gjithashtu, Ju njoftojmë se portali përdoret pasi të keni hapur një llogari në të. Nëse nuk e keni një të tillë, mund ta bëni duke zgjedhur këtë lidhje: https://e-albania.al/Pages/HelpRegister.aspx.</p> <p>Në vijim, për çdo paqartësi apo problem të hasur në përdorimin e portalit e-Albania, mund t'i drejtoheni postës elektronike – helpdesk@e-albania.al – kanal i posaçëm për përdorimin e portalit.</p> <p>Gjithë të mirat!</p>		
42	11.01.2021	Info mbi tërheqjen e diplomës	12.01.2021	<p>Përsëritje e nderuar,</p> <p>Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se për kërkesën Tuaj duhet të drejtoheni pranë sekretarisë së Universitetit ku keni kryer studimet e larta.</p> <p>Gjithë të mirat!</p>	E plotë	Nuk ka
43	11.01.2021	Info mbi shërbimin "Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridike (private dhe publike)"	12.01.2021	<p>Përsëritje,</p> <p>ne fushen e kerkimit te sherbimi Ju duhet te kerkoni sherbimin " Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridike (private dhe publike)"</p> <p>Duke Ju falenderuar,</p>	E plotë	Nuk ka
44	12.01.2021	Info mbi shërbimin "Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për	12.01.2021	<p>Përsëritje ,</p> <p>Në vijim të kërkesës Suaj për informacion, Ju informojmë se duhet të aplikoni shërbimin " Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë) " përmes platformës qeveritare e-Albania në</p>	E plotë	Nuk ka

		individët dhe personat juridike (private dhe publike)”		<p>linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477</p> <p>Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti. Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana juaj dhe të scanohet, dhe duhet të ngarkohet në hapin e tretë të formularit në e-albania. Për të përdorur shërbimin klikoni ‘Përdor’ në fund të faqes, vazhdoni me plotësimin e formularit elektronik. Klikoni butonin “Dërgo” në faqen e fundit të formularit; Numri i referencës së aplikimit do ju ndihmojë për të gjurmuar aplikimin dhe ngarkuar mandate-pagesën. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose kredit. Nëse pagesa kryhet në bankë ose postë, duhet që t’i riktheheni edhe njëherë aplikimit për të ngarkuar mandatpagesën.</p> <p>Ngarkimi i mandate-pagesës:</p> <p>Duhet të logoheni në e-albania, të kërkontë shërbimin e aplikuar, nuk do kryeni aplikim të ri por do shkoni në fund të formularit në seksionin dërgo mandate-pagesën e një aplikimi të kryer. Plotësoni të gjitha fushat, numrin e referencës së aplikimit e gjeni edhe tek mesazhet e mia , ngarkoni faturën pastaj klikoni ‘Dërgo’</p> <p>Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat); Nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 16:00. Faleminderit!</p>		
45	12.01.2021	Info rreth kartelës për fshirje të hipotekës së pasurisë	12.01.2021	<p>Pershendetje,</p> <p>Ne vijim të pyetjes Tuaj, ju sugjerojmë që në sesionin ku ju kërkohen të dhënat e pronës të vendosni vetëm zonen kadastrale dhe tek kutizat e vullm dhe faqe të vendosni 999</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>(tre ose dy nenta). Provojeni edhe nje here ne kete forme dhe ne rast se nuk arrini ta perfundoni, ju lutem paraqituni ne nje nga zyrat ADISA ne menyre qe te mund te perfundoni aplikimin nen asistencen e specialisteve tane.</p> <p>Ju mund te na kontaktoni ne numrin tone papagese 0800 0118 nga e hena ne te premte ne oren 08:00-15:00 qe tju mund tju asistojme edhe nga telefoni.</p> <p>Faleminderit!</p>		
46	12.01.2021	Info rreth përfitimit të KEMP-it	13.01.2021	<p>Përshëndetje e nderuar,</p> <p>Në vijim të kërkesës Suaj, Ju bëjmë me dije se në bazë të diagnozës tuaj dhe të analizave mjekësore ju mund të paraqiteni pranë ISSH për të përfituar KEMP të pjesshëm. Në bazë të grupit që do ju vendosi Komisioni ju mund të keni dhe lehtësira të tjera.</p> <p>Për çdo pyetje ose paqartësi mund të kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.</p> <p>Gjithë të mirat!</p>	E plotë	Nuk ka
